

VENDIM
Nr. 25, datë 21.3.2014

MBI KËRKESËN PËR FILLIMIN E NJË PROCEDURE HETIMORE ADMINISTRATIVE PËR SHPALLJEN ABSOLUTISHT TË PAVLEFSHME TË VENDIMEVE NR. 69 DHE 70, DATË 12.12.2007 TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s QË KANË TRANSFERUAR LICENCAT NGA SHOQËRITË KONCESIONARE “ESSEGEI SHQIPËRI SMOKTHINA” SHPK DHE “HYDROELECTRIC COMPANY OF ALBANIA” SHPK TE SHOQËRITË “ALBANIAN GREEN ENERGY” DHE “BALKAN GREEN ENERGY”

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 36, paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile; neneve 15 dhe 18, germa “b”, të ligjit nr. 8485 datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurës Administrative në Republikën e Shqipërisë”, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.3.2014, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s, lidhur me kërkesën e z. Grigor Zoraqi në cilësinë e personit të interesuar dhe ortakut të shoqërive koncesionare “Essegei Shqipëri Smokthina” sh.p.k. dhe “Hydroelectric Company of Albania” sh.p.k., për fillimin e një procedure hetimore administrative për shpalljen absolutisht të pavlefshme të vendimeve nr. 69 dhe 70, datë 12.12.2007 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s,

konstatoi se:

- Me vendim të Bordit Komisionerëve të ERE-s nr. 2, datë 3.4.2002, është licencuar shoqëria koncesionare “Essegei-Shqipëri” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.
- Me vendim nr. 2, datë 27.1.2003 të ERE-s i hiqet licenca shoqërisë “Essegei-Shqipëri” sh.p.k., për mosplotësim të kushteve të licencës dhe paaftësi menaxhuese dhe është caktuar si administrator, për të marrë përsipër shfrytëzimin e pajisjeve në licencë shoqëria “Essegei-Shqipëri Smokthina” sh.p.k., e cila do të plotësojë të gjitha detyrimet e përcaktuara në licencë.
- Me vendimin nr. 15, datë 27.8.2003, është licencuar nga ERE “Essegei Shqipëri Smokthina” sh.p.k., për prodhimin e energjisë elektrike, licencë nr. 05, seria PO3K.
- Me vendimin nr. 20, datë 19.12.2003, Bordi i Komisionerëve të ERE-s ka vendosur dhënien e licencës shoqërisë “Hidroelectric-Company d’Albania” sh.p.k. me cilësinë e shoqërisë koncesionare për shfrytëzimin e centraleve të dhëna me koncesion (licenca me nr. 13, seri PV03K).
- Me vendimin nr. 69, datë 12.12.2007 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, ka vendosur që licenca nr. 13, seria PVO3K, datë 19.12.2003 e shoqërisë “H.C.A” sh.p.k., t’i transferohet shoqërisë “Balkan Green Energy”, sh.p.k. Kjo shoqëri mban të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në licencën e prodhimit të energjisë elektrike nr. 13 seria PVO3K, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 20, datë 19.12.2003.
- Me vendimin nr. 70, datë 12.12.2007 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s është vendosur që licenca nr. 05, seria PO3K, datë 27.8.2003, e shoqërisë “Essegei Shqipëri Smokthina” sh.p.k. t’i transferohet shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k. Kjo shoqëri mban të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në licencën e prodhimit të energjisë elektrike nr. 05, seria PO3K, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 15, datë 27.8.2003.
- Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në bazë të vërtetimit datë 9.9.2013 të lëshuar nga kjo gjykatë është regjistruar çështja civile me nr. 171 Akti, datë 4.6.2009 depozitimi, dhe datë regjistrimi 5.6.2009 me palë paditëse Grigor Zoraqi; të paditur: Giorando Gorini, Aldo Francescheti, shoqëria “Essegei” s.p.a., shoqëria “Albanian Green Energy” sh.p.k., shoqëria “Balkan Green Energy” sh.p.k., Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës dhe Enti Rregullator i Energjisë.
- Kjo çështje vazhdon të jetë objekt konflikti gjyqësor ndër vite deri më sot, ku një nga palët ndërgjyqëse është edhe ERE dhe për rrjedhojë, kjo e fundit do të qëndrojë palë deri në zbardhjen nga drejtësia të kësaj çështje me vendim. Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Shpalljen e moskompetencës së ERE-s për shqyrtimin e kësaj çështjeje.
 2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti